

Drejtoria e Mbrojtjes se Konsumatoreve / 02.12.2004
Mamica Dharmo, Elfrida Bino

Raport

Mbi pjesemarrjen ne “Panair Nderkombetar 2004”

Drejtoria e Mbrojtjes se Konsumatoreve me mbeshtetjen e Programit CARDS 2003 Projekti “*Market Surveillance System Support to the Ministry of Economy in Albania*” si dhe te Agjensise Gjermane per Bashkepunim (GTZ), mori pjese ne ekspoziten “Panair Nderkombetar 2004” organizuar nga Klik Ekspo Klik. Ky aktivitet u zhvillua ne datat 25-30 Nentor 2004 ne ambientet e Qendres Nderkombetare te Kultures.

Qellimi i pjesemarrjes se DMK ne kete aktivitet ishte:

- paraqitja e aktivitetit te Drejtorise se Mbrojtjes se Konsumatoreve ne funksion te mbrojtjes se te drejtave te konsumatoreve dhe mbikqyrjes se tregut;
- ofrimi i mundesive per edukimin dhe rritjen e shkalles se ndergjegjesimit publik te konsumatoreve
- thithja e mendimeve apo opinioneneve te konsumatoreve apo perfaqesuesve te biznesit ne menyre te drejteperdrejte etj.

Per realizimin e ketij qellimi u shfrytezua frekuentimi i panairit nga qytetaret e Tiranes dhe te rretheve te tjera te vendit.

DMK ne pavionin e saj u paraqit me:

1. Banerin me siglat e DMK dhe mbeshtetesve te veprimtarise: Programit CARDS dhe GTZ.
2. Bazen ligjore te veprimtarise se DMK;
 - Ligji nr.9135, dt.11.09.2004 “*Per Mbrojtjen e Konsumatoreve*”;
 - Urdheri Nr.75, dt 17.03.2004 “*Per miratimin e Perberjes se Keshillit Bashkerendues per Mbrojtjen e Konsumatoreve*”;
 - Rregullore e funksionimit te Keshillit Bashkerendues etj.
3. Materialet informuese mbi veprimtarine e DMK si:
 - Fletepalosja mbi aktivitetin e DMK, mbikqyrjen e tregut si dhe parimet per mbrojtjen e konsumatoreve;
 - Fletepalosja mbi aktivitetin e DMK ne fushen e mbrojtjes se konsumatoreve;
4. Materiale te ndryshem sensibilizues dhe informues si:
 - Postera me mesazhe te ndryshem drejtuar konsumatoreve, “*10 Parimet e mbrojtjes se konsumatoreve ne BE*”, “*Urim i Ministrise se Ekonomise*”, “*Konsumoni qumesht te sigurte*”;
 - Dokumentari televiziv “*Respekti ndaj vehtes*”, etj.
5. Qese ambalazhi te stampuara me mesazhe drejtuar konsumatoreve, te cilat me kete rast ju shperndane konsumatoreve vizitues te panairit.
6. Projektimi i vazhdueshem i mesazheve mbi aktivitetin e DMK, te drejtat dhe parimet per mbrojtjen e konsumatoreve etj.

Gjithashtu ne ekspoziten “Panair Nderkombetar 2004” pati nje perfaqesim dinjitoz te biznesit shqiptar dhe atij te huaj. Permendim ketu perfaqesimin e firmave prodhuese apo importuese te mallrave si:

- ushqimore: bulmetit, mjaltit, perpunimit te frutave e perimeve, perimeve dhe frutave bio, te pijeve alkolike raki vere e birre, ta pijeve jo alkolike, lengje frutash, uje e pije te gazuara etj.
- veshje e tekstile te ndryshme;
- te perpunimit te drurit, mobilje;
- prodhimeve artistike e suvenireve;
- materiale ndertimi;
- si dhe per sherbime te ndryshme turistike etj.

Pavionet e biznesit sherbyen njekohesisht dhe si qendra tregtie per konsumatorët.

Gjate diteve te zhvillimi te panairit u vu re nje interesim i dukshem i vizitoreve (konsumatoreve) per pavionin e DMK. Gje qe u shpreh me numrin e madh te shperndarjeve te fletepalosjeve, broshures se Ligjit Nr.9135, dt.11.09.2003 “*Per Mbrojtjen e Konsumatoreve*” si dhe qeseve te stampuara me mesazhe etj. Njekohesisht pati nje interesim te drejteperdrejt per aktivitetin e DMK shprehur nepermjet pyetjeve te ndryshme ku nder me kryesoret permendim:

- A eshte DMK nje strukture ekzekutuese apo keshillimore?
- Cili eshte roli i DMK-se ne kontrollin e drejteperdrejte te tregut?
- Çfare marredheniesh ka DMK me shoqaten e Konsumatorit Shqiptar?
- Si mund te anetaresohemi ne ShKSh?
- Si mund te interpretohen parimet e konsumatorit?
- Kush eshte autoriteti qe trajton problemet e konkurrences se pandershme?

Gjate qendrimit ne panair nga ana e DMK-se u vune re:

- Mungesa e etiketimit ne gjuhen shqipe ne disa prej prodhimeve.
- Ne nje prej prodhimeve u vu re edhe kalimi i afatit te dates se skadences.

Nga ana e DMK-se, pjesemarrja e saj ne nje aktivitet te tille, si eksperience e pare, u konsiderua e dobishme, duke patur parasysh interesimin e vizitoreve (konsumatoreve) si dhe te firmave pjesemarrrese ne panair.